

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 1, datë 10.6.2026

PËR KRITERET, PROCEDURAT, TREGUESIT PËR SHPËRNDARJEN E FONDIT TË GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË, PËR BASHKITË, PËR VITIN 2026

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të pikës 11, të nenit 15 dhe pikës 6, të Aneksit 9, të ligjit nr. 87/2025, “Për Buxhetin e vitit 2026”.

UDHËZOJMË:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky udhëzim përcakton kriteret, treguesit dhe procedurat e shpërndarjes së fondit të Grantit të Bazuar në Performancë, i cili do t’u shpërndahet bashkive për vitin 2026.

2. Çdo bashki ka të drejtë të aplikojë për të përfituar fonde nga Granti i Bazuar në Performancë.

3. Aplikimi duhet të kryhet në përputhje me afatet kohore, mënyrën, kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Fondet e përfituara nga Granti i Bazuar në Performancë përdoren nga bashkitë sipas nevojave të tyre dhe në asnjë rast për kryerjen e shpenzimeve për personelin dhe/ose shpërblime.

II. PËRKUFIZIME

1. “Granti i Bazuar në Performancë (GBP)” – është një mekanizëm i bashkëfinancuar nga qeveria shqiptare dhe nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, dhe qeveria e Suedisë, të përfaqësuara nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), bazuar në marrëveshjen e bashkëfirmosur nga palët sipas ligjit nr. 114/2024, “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për projektin ‘Bashki të Forta (BTF), faza 2’”.

2. “AMVV” – është Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

3. “Donator” – është Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC)/Ambasada e Zvicrës dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA).

4. “KVA” – është Komisioni i Vlerësimit të Aplikimeve, përgjegjës për kryerjen e vlerësimit administrativ të dokumentacionit të paraqitur nga bashkitë në përputhje me këtë udhëzim.

5. “ST” – është Sekretariati Teknik në AMVV, përgjegjës për menaxhimin e procedurave administrative.

III. TREGUESIT PËR SHPËRNDARJEN E GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË

1. Vlerësimi i treguesve nga KVA-ja bëhet bazuar në kriteret e përcaktuara në anekset e këtij udhëzimi. Alokimi/ndarja e fondeve të GBP-së bëhet mbi përlllogaritjen e fondit për secilin plan/tregues performance për GBP-në dhe kryhet duke aplikuar peshën përkatëse ndaj fondit total të komponentit, sipas metodologjisë së përcaktuar në këtë udhëzim.

2. Bashkitë që kanë aplikuar për GBP dhe që vlerësohen se përmbushin treguesit e përcaktuar në këtë udhëzim, përfitojnë një shumë monetare përkatëse sipas peshës së caktuar për secilin tregues dhe në përpjestim të drejtë me të gjitha bashkitë të cilat vlerësohen fituese për secilin tregues.

3. Granti i Bazuar në Performancë përbëhet nga dy komponentë:

a) **Komponenti I:** Ky komponent synon të nxisë hartimin dhe përditësimin e dokumenteveve strategjike vendore, në funksion të rritjes së performancës së bashkive dhe përbën 38% të fondit total prej 250 milionë lekë të GBP-së 2026 ose ekuivalent 95 milionë lekë;

Tregues GBP-je 2026	Pesha në %	Fondi në lekë
Komponenti I – Planet vendore	100%	95,000,000
Plani Vendor i Mbarështimit të Pyjeve	30 %	28,500,000
Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	20 %	19,000,000
Plani Vendor Social	15 %	14,250,000
Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	15 %	14,250,000
Plani Vendor i Integritetit	10 %	9,500,000
Plani Vendor i Barazisë Gjimore	10 %	9,500,000

b) **Komponenti II:** Ky komponent synon të vlerësojë performancën e bashkive në zbatimin e planeve vendore dhe arritjen e objektivave përmes treguesve të matshëm të rezultateve dhe përbën 62% të fondit total prej 250 milionë lekë të GBP-së 2026 ose ekuivalent 155 milionë lekë.

Tregues GBP-je 2026	Pesha në %	Fondi në lekë
Komponenti II – Tregues të Matshëm Rezultati	100%	155,000,000
Shkalla e regjistrimit në kopshtet publike është jo më e vogël se 60% për vitin 2025.	10%	15,500,000
% e riciklimit të të ardhurave nga ekonomia pyjore të realizuara me planifikimin/fakt në këtë sektor është jo më e vogël se 70% për vitin 2025.	10%	15,500,000
Gjatë vitit 2025 bashkia ka mbuluar të paktën 50% të kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga tarifa (raporti tarifa e mbledhur/kosto e shpenzuar).	10%	15,500,000
Deri në 30 qershor 2026, bashkitë e vogla do të shtojnë <u>1 shërbim social</u> , bashkitë e mesme <u>2 shërbime sociale</u> dhe bashkitë e mëdha <u>3 shërbime sociale</u> .	10%	15,500,000
Paketa e emergjencës për viktimat e dhunës është planifikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2026.	10%	15,500,000
Bashkia ka zbatuar gjatë vitit 2025 të paktën 50% të masave të parashikuara në Planin Vendor të Integritetit për vitin 2025.	10%	15,500,000
Bashkia ka raportuar të dhënat përkatëse për të gjithë treguesit e Raportit Kombëtar të Performancës 2025 brenda afatit të përcaktuar në udhëzim.	10%	15,500,000
Niveli i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në periudhën e vlerësimit kundrejt periudhës referuese është mbi 30%. Bashkitë të cilat nuk kanë detyrime të prapambetura në periudhën referuese vlerësohen me pikët maksimale për këtë tregues.	10%	15,500,000
Realizimi i buxhetit për periudhën referuese kundrejt planit vjetor të buxhetit është në nivelin mbi 35%.	10%	15,500,000
Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me të paktën 20% në 6-mujorin e parë të 2026-ës ndaj të njëjtës periudhë të 2025-ës.	10%	15,500,000

IV. PROCEDURA ADMINISTRATIVE PËR PËRFITIMIN E GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË

A. Detyrat dhe përgjegjësitë e bashkive aplikuese

1. Çdo bashki dorëzon pranë AMVV-së dokumentacionin e aplikimit për GBP-në me **shkresë zyrtare ose me email**, deri në datën 24.7.2026 dhe jo më vonë se ora 16.00 e kësaj date. Aplikimet protokollohen nga AMVV-ja.

2. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet me shkresë përcjellëse, e cila duhet të përmbajë listën e dokumenteve të paraqitura, si dhe kategorizimin për secilin tregues, me qëllim lehtësimin e aksesit dhe verifikimit gjatë fazës së vlerësimit për përputhshmëri.

3. Bashkitë aplikuese, pas njoftimit për vlerësimin paraprak, kanë të drejtën të paraqesin me shkrim në AMVV komente ose vërejtje, brenda afatit 3 (tre) ditë lidhur me vlerësimin e treguesit përkatës.

4. Bashkitë fituese pasi janë informuar për vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve bëjnë me dije Këshillin Bashkiak përkatës, i cili në përputhje të plotë me përcaktimet e ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, merr vendimin për përcaktimin e destinacionit të përdorimit të fondit me burim financimi të huaj dhe të brendshëm.

5. Pas marrjes së vendimit nga Këshilli Bashkiak, për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të fondit me burim financimi të huaj dhe të brendshëm, i kërkojnë Ministrisë së Financave çeljen e kodit të produktit/projektit për të cilin do të përdoret ky fond.

6. Bashkitë kanë pavarësi të plotë në përcaktimin e destinacionit të përdorimit të këtij fondi, me përjashtim të zërit “paga” dhe “shpërblime”.

7. Bashkitë mbajnë dhe ruajnë evidencë të plotë të përdorimit të fondit të grantit me burim financimi buxhetin e shtetit dhe nga donatorët, dhe raportojnë pranë Ministrisë së Financave mbi progresin e përdorimit të fondit të përfituar nga GBP-ja.

B. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve:

1. Kryetar i KVA-së është përfaqësuesi i ministrit për Pushtetin Vendor.

2. KVA-ja përbëhet nga 3 tre anëtarë/anëtare:

a) një anëtar/anëtare i/e propozuar nga ministri për Pushtetin Vendor;

b) një anëtar/anëtare i/e propozuar nga Ministria e Financave;

c) një anëtarë/anëtare të propozuar nga ministria përkatëse e cila mbulon fushën e përgjegjësisë së treguesit/planit të marrë në vlerësim.

3. KVA-ja vlerëson dokumentacionin e dorëzuar nga secila bashki sipas kriterëve të cilësisë së përcaktuara në aneksin 3 të këtij udhëzimi dhe miraton rezultatin paraprak dhe atë përfundimtar të vlerësimit. AMVV-ja publikon rezultatet dhe njofton bashkitë pjesëmarrëse në *website*-in zyrtar të saj.

4. Zbatimi i pikës 8, në kreun IV.C, është kusht i vlefshmërisë së procesit për Komisionin e Vlerësimit të Aplikimeve dhe përbën element thelbësor të rregullsisë dhe integritetit të procesit të vlerësimit.

5. KVA-ja shqyrton komentet ose vërejtjet e paraqitura nga bashkitë brenda afatit të përcaktuar dhe brenda 3 ditësh nga data e paraqitjes së tyre miraton vlerësimin përfundimtar të aplikimeve.

C. Detyrat dhe përgjegjësitë e AMVV-së në cilësinë e Sekretariatit Teknik:

1. AMVV-ja kryen detyrat e sekretariatit teknik dhe kujdeset për administrimin e praktikave të të gjithë procedurave administrative të përcaktuara sipas këtij udhëzimi.

2. AMVV-ja njofton të gjitha bashkitë për hapjen e thirrjes përmes publikimit në faqen zyrtare të internetit dhe njoftimit zyrtar me shkrim.

3. Njoftimi përmban informacionin, mbi:

a) afatin e dorëzimit të dokumentacionit;

b) mënyrën e dorëzimit të aplikimit.

4. AMVV-ja mund të ofrojë mbështetje informuese dhe teknike gjatë përgatitjes së aplikimeve, e cila nuk përbën pjesë të procedurës administrative të vlerësimit dhe nuk krijon të drejta, avantazh apo trajtim të veçantë për bashkitë aplikuese.

5. AMVV-ja administron dokumentacionin e dorëzuar nga bashkitë, duke kryer regjistrimin dhe protokollimin e tij.

6. AMVV-ja verifikon rregullsinë formale të dokumentacionit të paraqitur, në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara në këtë udhëzim dhe anekset përkatëse. Verifikimi që bën AMVV-ja ka karakter formal dhe dokumentar dhe nuk përfshin në asnjë rast vlerësimin e përmbajtjes apo cilësisë së treguesve.

7. Pas përfundimit të afatit të dorëzimit, aplikimi nga bashkitë konsiderohet i mbyllur.

8. AMVV-ja është përgjegjëse për organizimin e takimeve me KVA-në, për vënien në dispozicion të deklaratave për nënshkrimin e konfidencialitetit dhe konfliktit të interesit, si dhe

formularëve të vlerësimit për treguesit përkatës.

9. AMVV-ja njofton me shkrim dhe me *email* bashkitë aplikuese dhe publikon në faqen e saj zyrtare rezultatet e vlerësimit paraprak dhe procesverbalin e takimit për çdo tregues të GBP-së.

10. AMVV-ja administron ankesat e paraqitura nga bashkitë dhe i përcjell KVA-së dokumentacionin për shqyrtim dhe miratim të vlerësimit përfundimtar për treguesit e GBP-së 2026. Në rast se brenda afatit të përcaktuar nuk paraqitet asnjë koment apo vërejtje, vlerësimi paraprak konfirmohet si vlerësim përfundimtar.

11. AMVV-ja publikon në faqen e saj zyrtare **rezultatet e vlerësimit përfundimtar** për çdo tregues të GBP-së dhe njofton me shkrim dhe me *email* bashkitë.

12. Vendimet e KVA-së për vlerësimin përfundimtar të aplikimit për çdo bashki dhe tabela përmbledhëse e shpallur nga AMVV-ja i përcillen Ministrisë së Financave nga drejtori i përgjithshëm i AMVV-së.

V. PROCEDURA SPECIFIKE PËR AKORDIMIN E GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCE

1. Pas njoftimit nga AMVV-ja mbi vlerësimin përfundimtar të KVA-së, Ministria e Financave përcakton shumën dhe burimin e financimit të grantit të bazuar në performancë, për secilën prej bashkive përfituese.

2. Granti i bazuar në performancë, për vitin 2026 ka burim financimi:

a) **të brendshëm**, në shumën 200 milionë lekë, si zë i veçantë i fondit të akorduar për buxhetin vendor si transfertë e pakushtëzuar sektoriale;

b) **të huaj**, në shumën 50 milionë lekë nga qeveria e Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA).

A. Procedurat për akordimin e fondeve me burim financimi të brendshëm të Grantit të Bazuar në Performancë të bashkitë përfituese:

1. Ministria e Financave shpërndan fondin e Grantit të bashkitë përfituese.

2. Granti i Bazuar në Performancë në vitin 2026 do të shpërndahet në bashkitë përfituese në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale.

3. Fondet e papërdorura nga Granti i Bazuar në Performancë, të përfituara nga bashkitë në vitin 2026 me burim financimi transfertën e pakushtëzuar sektoriale, trashëgohen në vitin 2027 për t'u përdorur për të njëjtin destinacion/qëllim.

B. Procedurat për akordimin e fondeve me burim financimi të huaj të Grantit të Bazuar në Performancë të bashkitë përfituese

1. Fondet e financimit të huaj për Grantin e Bazuar në Performancë përfitohen në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes, mbi bazën e marrëveshjes përkatëse midis qeverisë së Zvicrës dhe asaj shqiptare sipas ligjit nr. 114/2024, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri, për projektin 'Bashki të Forta (BTF), faza 2'", dhe menaxhohen bazuar në udhëzimin nr. 10, datë 12.7.2024, "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", sipas skemës me thesar të plotë.

2. Disbursimi dhe ekzekutimi i fondeve të Grantit të Bazuar në Performancë bëhet nëpërmjet llogarisë së unifikuar të thesarit (TSA) në Bankën e Shqipërisë (BSH).

3. Për të transferuar fondet nga donatori në TSA, në mbështetje të marrëveshjes të miratuar me ligjin nr. 114/2024, të sipërcituar, struktura e përcaktuar për të menaxhuar fondet e financimit të huaj për Grantin e Bazuar në Performancë në ministrinë përgjegjëse për financat, i dërgon zyrtarisht (me firmë të nëpunësit/nëpunëses së parë autorizues/e) donatorit

(Ambasadës Zvicerane/SDC) Formularin e Identifikimit Financiar (FIF), të plotësuar sipas formatit në aneksin nr. 2, të udhëzimit nr. 10, datë 12.7.2024, “Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”.

4. Formulari i Identifikimit Financiar, përveç referencave të TSA-së, në fushën REMARK përmban edhe kodin e produktit me emërtimin “Grant Performance për Bashkitë”, i cili çelet nga struktura përgjegjëse për thesarin në qendër, me kërkesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit.

5. SDC-ja/Ambasada Zvicerane, pasi merr Formularin e Identifikimit Financiar të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për financat, sipas pikës 3 më sipër, kryen disbursimin e financimit të huaj (në euro), duke vendosur në përshkrimin e transfertës bankare të dhënat e fushës REMARK të FIF-së.

6. Bazuar në njoftimin e Bankës së Shqipërisë, struktura përgjegjëse për thesarin në qendër krediton llogarinë ekonomike “106xxxx” në sistemin informatik financiar të qeverisë (SIFQ) pa specifikuar institucionin, ministrinë e linjës dhe duke përdorur kodin teknik të produktit **90005AF “Granti i Performancës”**.

7. Bazuar në informacionin e paraqitur nga struktura përgjegjëse për financat vendore në Ministrinë e Financave kryhet transferimi i fondit nga struktura përgjegjëse për thesarin në qendër, duke debituar kod institucioni 0000000, ministri linje 00, llogari ekonomike 106xxxx, kod teknik produkti 90005AF (sipas pikës 6 më sipër), dhe kredituar kod institucioni kodin e bashkisë përkatëse, kod ministrie linje 00, dhe kodin teknik të produktit 90005AF.

Struktura përgjegjëse për thesarin në degë bën alokimin në plan thesari të arkëtimit në llogarinë ekonomike “106xxxx”, duke përdorur kodin teknik të produktit 90005AF “Granti i Performancës”.

Më pas bëhet vetëm rishikim në plan thesari, nga kodi teknik i produktit 90005AF, në kodin specifik të produktit që kërkon të përdorë fondet bashkia përkatëse.

8. Alokimi i fondeve për shpenzim bëhet me kapitullin 02 “Financimi i huaj”.

9. Fondi i pashpërndarë në TSA gjatë vitit buxhetor, shpërndahet në vitin buxhetor pasardhës për të njëjtin qëllim, vetëm me vendim të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve.

10. Gjendja e fondit të prokuruar dhe të papërdorur nga bashkitë në fund të vitit buxhetor trashëgohet në vitin buxhetor pasardhës dhe përdoret për të njëjtat projekte/produkte për të cilin është prokuruar.

11. Gjendja e fondit të ngelur tepriçë nga procesi i prokurimit përdoret nga bashkitë për qëllime të tjera që ato gjykojnë dhe vendosin me vendim të këshillit bashkiak.

VI. MONITORIMI, RAPORTIMI DHE AUDITIMI I GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCE

1. Ministria e Financave, bazuar në raportimet e bashkive publikon përdorimin e fondeve të GBP-së. Raportet u dërgohen AMVV-së dhe donatorëve nga Ministria e Financave.

2. Të gjitha fondet e financuara përmes GBP-së i nënshtrohen auditimit sipas legjislacionit në fuqi. Auditimi realizohet nga institucione të pavarura të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

3. Donatorët kanë të drejtë të kryejnë monitorime në terren dhe të kërkojnë me shkrim auditimin e përdorimit të fondeve grant të dhëna sipas këtij udhëzimi, për raste të veçanta, kur shuma e grantit është më e madhe se 4 milionë lekë dhe e përdorur në një projekt të vetëm. Në këto raste, auditimi mund të kryhet nga subjekte të angazhuara posaçërisht nga donatorët e grantit dhe shpenzimet e auditimit në këto raste mbulohen nga donatorët.

4. Donatorët kanë të drejtë të jenë të pranishëm në të gjitha procedurat e administrimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të performancës së bashkive dhe të njihen me çdo dokumentacion të paraqitur. Përfaqësuesit e donatorëve kanë të drejtë të shprehin qëndrimin e tyre me shkrim drejtuar KVA-së dhe AMVV-së për çdo fazë të procesit pa shkaktuar vonesa

në aplikimin dhe vlerësimin sipas këtij udhëzimi.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohet Ministria e Financave, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe bashkitë për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Institucionet e përfshira në KVA, të parashikuara në kapitulli IV, nënkaptulli B, të dërgojnë me shkresë zyrtare pranë AMVV-së emrat e përfaqësuesve të tyre, brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

3. Pjesë integrale e këtij udhëzimi janë anekset, si më poshtë:

a) aneksi 1: Afatet kohore, forma e dorëzimit për procedurën e aplikimit, shpërndarja dhe përdormi i fondit GBP;

b) aneksi 2: Vlerësimi nga AMVV-ja i dokumentacionit të paraqitur nga bashkitë;

c) aneksi 3: Vlerësimi nga KVA-ja i cilësisë së planeve të paraqitura nga bashkitë dhe i Treguesve të Matshëm të Rezultatit;

d) aneksi 4: Përlllogaritja e shumave që përfitojnë bashkitë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHTETIT
PËR PUSHTETIN VENDOR
Ervin Demo

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

Aneks 1

Afatet kohore, forma e dorëzimit për procedurën e aplikimit, shpërndarja dhe përdormi i fondit GBP

- | | |
|---|--------------------------|
| - Periudha e përgatitjes për aplikime nga bashkitë: | Deri më 24 korrik 2026; |
| - Ofrimi i mbështetjes për bashkitë (trajnim, shembuj): | Deri më 24 korrik 2026; |
| - Dorëzim me shkresë/ <i>email</i> , dokumentet strategjike (CD/USB): | Deri më 24 korrik 2026; |
| - Shqyrtimi i aplikimeve nga Sekretariati Teknik: | Deri më 15 shtator 2026; |
| - Vlerësimi i bashkive fituese nga KVA-ja: | Deri më 15 tetor 2026; |
| - Përlllogaritja e fondit për t'u shpërndarë: | Deri më 15 nëntor 2026; |
| - Alokimi i fondeve: | Nëntor–dhjetor 2026; |
| - Përfshirja në buxhetin vendor: | dhjetor 2026; |
| - Monitorim dhe raportim: | Janar–qershor 2027. |

Aneks 2

Vlerësimi nga AMVV-ja i dokumentacionit të paraqitur nga bashkitë

• AMVV-ja verifikon dokumentacionin e paraqitur nga bashkitë, duke kontrolluar përputhshmërinë e tij me kërkesat dhe kriteret e parashikuara në aneksin përkatës.

• Për GBP-në e vitit 2026, treguesit quhen të plotësuar nëse përputhen me afatet e përcaktuara për çdo tregues tregues.

Nr.	Treguesi i GBP-së	Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga bashkia	Verifikimi që bën AMVV-ja
1	Një Plan Mbarështimi Pyjesh i miratuar nga MTM-ja në	Plani i Mbarështimit të Pyjeve për ekonominë pyjore të përzgjedhur nga	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.

	periudhën 17 shtator 2025 – 24 korrik 2026 (për këtë tregues do të merret parasysh edhe vetëm një ekonomi pyjore).	bashkia përkatëse. Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit të Mbarështimit të Pyjeve, për ekonominë pyjore të përzgjedhur nga bashkia përkatëse. Urdhri i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit që miraton Planin e Mbarështimit të Pyjeve për ekonominë pyjore të përzgjedhur nga bashkia përkatëse.	Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e planit vendor brenda periudhës referuese. Urdhri tregon miratimin e planit për ekonominë përkatëse pyjore.
2	Një Plan Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 17 shtator 2025–24 korrik 2026.	Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	Dokumenti i planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Mbetjeve për bashkinë përkatëse.	Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e planit vendor brenda periudhës referuese.
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti.	Akti konfirmon VKB-në përkatëse.
3	Një Plan Social Vendor i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 17 shtator 2025–24 korrik 2026.	Plan Social Vendor.	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Social Vendor për bashkinë përkatëse.	Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e planit vendor brenda periudhës referuese.
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti.	Akti konfirmon VKB-në përkatëse.
4	Një Plan Vendor i Arsimit Parauniversitar i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 17 shtator 2025–24 korrik 2026.	Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar.	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor të Arsimit Parauniversitar për bashkinë përkatëse.	Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor brenda periudhës referuese.
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti.	Akti konfirmon VKB-në përkatëse.
5	Një Plan Vendor i Integritetit i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 17 shtator 2025–24 korrik 2026.	Plani Vendor i Integritetit.	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor të Integritetit për bashkinë përkatëse.	Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor brenda periudhës referuese.
6	Një Plan Vendor i Barazisë Gjinore i miratuar nga Këshilli Bashkiak përkatës në periudhën 17 shtator 2025 – 24 korrik 2026.	Plani Vendor i Barazisë Gjinore.	Dokumenti i Planit është dorëzuar nga bashkia përkatëse.
		Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor të Barazisë Gjinore për bashkinë përkatëse.	Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Planit Vendor brenda periudhës referuese.
		Akti i konfirmimit të VKB-së nga Prefekti.	Akti i konfirmimit të VKB-së nga prefekti.
7	Shkalla e regjistrimit në kopshtet publike është jo më e vogël se 60% për vitin 2025.	Raportimi i të dhënave për treguesit e matjes së performancës për vitin 2025.	Verifikon që të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë brenda afatit të përcaktuar në udhëzimet për ushtrimin e matjes së treguesve të performancës. Krahason të dhënat e raportuara nga bashkitë me të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit.
			Verifikon shkallën e regjistrimit në kopshte publike dhe përgatit rezultatet për KVA-në.
8	% e riciklimit të të ardhurave nga ekonomia pyjore të	Raportimi i të dhënave për treguesit e matjes së performancës për vitin 2025.	Verifikon që të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë brenda

	realizuara me planifikimin/fakt në këtë sektor është jo më e vogël se 70% për vitin 2025.		afatit të përcaktuara në udhëzimet për ushtrimin e matjes së treguesve të performancës. Krahason të dhënat e raportuara nga bashkitë me të dhënat administrative nga Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve. Verifikon shkallën e riciklimit të të ardhurave nga ekonomia pyjore dhe përgatit rezultatet për KVA-në.
9	Të paktën 50% e mbulimit të kostos nga tarifa për menaxhimin e mbetjeve.	Raportimi i të dhënave për treguesit e matjes së performancës për vitin 2025.	Verifikon që të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë brenda afatit të përcaktuara në udhëzimet për ushtrimin e matjes së treguesve të performancës. Krahason të dhënat e raportuara nga bashkitë me të dhënat administrative nga Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve. Verifikon shkallën e mbulimit të kostos nga tarifa për menaxhimin e mbetjeve dhe përgatit rezultatet për KVA-në.
10	Deri në qershor 2026, bashkitë e vogla do të shtojnë 1 shërbim social, bashkitë e mesme 2 shërbime sociale dhe bashkitë e mëdha 3 shërbime sociale.	Raportimi i shërbimeve sociale të shtuara me dokumentet përkatëse. Treguesi shpreh zgjerimin e shërbimeve që ofron bashkia, me të paktën 1 shërbim për bashkitë me popullsi nën 10000 banorë, 2 shërbime për bashkitë me popullsi nga 10000 – 50000 banorë dhe 3 shërbime për bashkitë me popullsi mbi 50000 banorë.	Verifikon nëse janë shtuar këto shërbime ndërmjet dokumentacioneve, si: vendimi Këshillit Bashkiak, urdhër i brendshëm, emërime stafi për shërbime sociale shtesë, kontrata etj., gjatë periudhës 1 janar 2025–30 qershor 2026.
11	Paketa e emergjencës për viktimat e dhunës, e planifikuar në buxhetin e 2026-ës.	Vendimi i Këshillit Bashkiak mbi miratimin e planifikimit buxhetor 2026.	Verifikon nëse buxheti i miratuar ka të planifikuar paketën e emergjencës për viktimat e dhunës ndërmjet dokumentacioneve, si: vendimi i Këshillit Bashkiak.
12	Raporti i Monitorimit të Planeve të Integritetit me masat e vitit 2025 të zbatuara të paktën me 50%.	Raportimi nga bashkitë për realizimin e masave 2025.	Verifikon përputhshmërinë ndërmjet raportimit të kryer nga bashkia dhe evidencave për zbatimin e masave. Verifikon shkallën e zbatimit të masave dhe përgatit rezultatet për KVA-në.
13	Bashkia ka raportuar të dhënat përkatëse për të gjithë treguesit e Raportit Kombëtar të Performancës 2025 brenda afatit të përcaktuar në udhëzim.	Raportimi i të dhënave për treguesit e matjes së performancës për vitin 2025.	Verifikon që të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë brenda afatit të përcaktuara në udhëzimet për ushtrimin e matjes së treguesve të performancës.
14	Bashkia ka shlyer detyrimet e prapambetura me të paktën 30%, në periudhën referuese, nga data 31.12.2025–30.6.2026.	Raporti i detyrimeve të prapambetura gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i qeverisë.	Verifikon informacionin e dërguar nga Ministria e Financave. Bashkitë të cilat nuk kanë detyrime të prapambetura vlerësohen me të gjitha pikët për këtë tregues.
15	Bashkia ka realizim faktik të buxhetit në 6-mujorin e parë 2026 ndaj planit vjetor për	Raporti i të dhënave për planin dhe faktin e realizimit të buxhetit të bashkive, për periudhën referuese,	Verifikon informacionin e dërguar nga Ministria e Financave.

	vitin 2026 jo më pak se 35%.	gjeneruar nga Sistemi Informatik Financiar i qeverisë.	
16	Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me 20% në 6-mujorin e parë të 2026-ës ndaj të njëjtës periudhë të 2025-ës. Në këtë vlerësim nuk përfshihet taksa e transaksioneve mbi pasurinë e paluajtshme.	Raportimi i të dhënave nga bashkitë për realizimin e të ardhurave nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme. Raporti i Sistemit Informatik Financiar të qeverisë.	DPTP-ja pas verifikimit dhe analizimit të të dhënave të dërguara nga bashkitë dhe në përputhje me raportin e gjeneruar nga SIFQ-ja dërgon materialin për koment dhe verifikim të AMVV-ja.

Aneks 3

Vlerësimi nga KVA-ja i cilësisë së Planeve të paraqitura nga bashkitë dhe treguesve të matshëm të rezultatit

1. KVA-ja vlerëson planet vendore e treguesit e tjerë të paraqitura nga bashkitë, dhe verifikon se:

- a) Dokumentacioni i paraqitur iu referohet treguesve të GBP-së;
- b) Planet e paraqitura plotësojnë kriteret e përcaktuara të cilësisë.

2. Mosplotësimi i qoftë edhe njërit prej kriterëve të cilësisë, tregon që kriteri i performancës (plani) të konsiderohet jo i përmbushur.

3. KVA-ja përbëhet nga:

- a) Një anëtar/anëtare nga ministria përgjegjëse për pushtetin vendor;
- b) Një anëtar/anëtare nga Ministria e Financave;
- c) Një anëtar/anëtare nga ministria e linjës sipas treguesit/planit.

4. Kriteret e cilësisë për secilin tregues janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Treguesi i performancës i GBP-së	Kriteret e cilësisë së planeve vendore dhe treguesve të matshëm të rezultatit
1	Plani i Mbarëshimit të Pyjeve	Në përputhje me udhëzimet/kërkesat e MTM-së.
2	Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	Planet në fushën e menaxhimit të mbetjeve i nënshtrohen procesit të vlerësimit strategjik mjedisor, referuar nenit 2, të ligjit nr. 91/2013, "Për vlerësimin strategjik mjedisor", të ndryshuar. Plani parashikon përqindjen e mbulimit të kostos nga tarifa. Plani parashikon përqindjen e mbulimit me shërbim, të: i. territorit; dhe/ose ii. popullsisë. Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit. Plani përmban një mekanizëm monitorimi. Plani mbulon një periudhë 5-vjeçare.
3	Plani Vendor Social	Plani përmban analizën e nevojave për shërbime sociale bazuar në: a) numrin e popullsisë; b) shkallën e papunësisë; c) numrin e përfituesve të Ndihmës Ekonomike; d) numrin e personave me aftësi të kufizuara; e) numrin e shërbimeve sociale të ofruara, të ndara sipas tipologjisë së shërbimeve; f) numri i përfituesve për çdo shërbim, të ndara sipas gjinisë. Plani shpreh zgjerimin e hartës së shërbimeve, që ofron bashkia, me të paktën 1 shërbim për bashkitë me popullsi nën 10000 banorë, 4 shërbime për bashkitë me popullsi nga 10000–50000 banorë dhe 10 shërbime për bashkitë me popullsi mbi 50000 banorë. Plani përmban kalendarin e aktiviteteve për çdo vit, si dhe financimin e aktivitetit/shërbimit që specifikon burimin që mbështet (buxheti i bashkisë/buxheti kombëtar/donorë). Plani përmban metodologjinë e monitorimit dhe njësinë e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të aktivitetit dhe treguesit e matjes së performancës së shërbimeve të kujdesit shoqëror.

		Plani mbulon një periudhë të paktën 3-vjeçare.
4	Plani i arsimit parauniversitar	<p>Përmban një plan masash për rritjen e pjesëmarrjes dhe sigurimin e gjithëpërfshirjes në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.</p> <p>Plani përmban analizën dhe shpërndarjen e infrastrukturës arsimore në territorin e bashkisë.</p> <p>Plani përmban analizën dhe shpërndarjen e stafit arsimor në territorin e bashkisë.</p> <p>Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit.</p> <p>Plani përmban një mekanizëm monitorimi.</p> <p>Plani duhet të mbulojë një periudhë të paktën 3-vjeçare.</p>
5	Plani i Integritetit	<p>Plani është në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024–2030.</p> <p>Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit.</p> <p>Plani përmban një mekanizëm monitorimi.</p> <p>Plani duhet të mbulojë një periudhë të paktën 3-vjeçare.</p>
6	Plani i barazisë gjinore	<p>Plani të përmbajë të paktën një paketë emergjence për viktimat e dhunës me masat dhe buxhetin e nevojshëm. Plani të përmbajë masa dhe veprime që parashikohen bazuar në SKBGJ 2021–2030.</p> <p>Plani përmban kalendarin e veprimtarive të buxhetuara për çdo vit.</p> <p>Plani përmban një mekanizëm monitorimi.</p> <p>Plani duhet të mbulojë një periudhë të paktën 3-vjeçare.</p>
7	Shkalla e regjistrimit në kopshtet publike është jo më e vogël se 60% për vitin 2025	Të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë brenda afatit për të gjithë treguesit e matjes së performancës dhe treguesi është jo më pak se 60%.
8	% e riciklimit të të ardhurave nga ekonomia pyjore të realizuara me planifikimin/fakt në këtë sektor është jo më e vogël se 70% për vitin 2025	Të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse janë brenda afatit për të gjithë treguesit e matjes së performancës dhe % e riciklimit të të ardhurave nga ekonomia pyjore të realizuara me planifikimin/fakt në këtë sektor është jo më e vogël se 70% për vitin 2025.
9	Të paktën 50% e mbulimit të kostos nga tarifa për menaxhimin e mbetjeve	Gjatë vitit 2025 bashkia ka raportuar brenda afatit për të gjithë treguesit e matjes së performancës dhe ka mbuluar të paktën 50% të kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga tarifa (raporti tarifa e mbledhur/kosto e shpenzuar).
10	Deri në qershor 2026, bashkitë e vogla do të shtojnë 1 shërbim social, bashkitë e mesme 2 shërbime sociale dhe bashkitë e mëdha 3 shërbime sociale.	Një shërbim social të konsiderohet funksional vetëm kur disponon dokumentacionin e shoqëruar me vendim të Këshillit Bashkiak, urdhër të Brendshëm, emërim stafi për shërbime sociale shtesë, kontrata, buxhet të dedikuar dhe evidencë të ofrimit të shërbimit.
11	Paketa e emergjencës për viktimat e dhunës, e planifikuar në buxhet 2026	Disponimi i një vlere minimale financiare dhe/ose përcaktimi i zërit përkatës buxhetor dhe buxheti i miratuar ka të planifikuar paketën e emergjencës për viktimat e dhunës nëpërmjet dokumentacioneve/procesverbaleve ku është miratuar buxheti.
12	Raporti i Monitorimit të Planeve të Integritetit me masat e vitit 2025 të zbatuara të paktën me 50%	Raportimi i masave të kryhet i plotë, i saktë dhe me dokumentacion mbështetës për verifikimin e tij.
13	Të dhënat e raportuara nga bashkia përkatëse për të gjithë treguesit janë brenda afatit të përcaktuar në udhëzim	Raportimi i të dhënave të kryhet i plotë, i saktë dhe brenda afatit të përcaktuar në udhëzim për të gjithë treguesit e kërkuar.
14	Bashkia ka shlyer detyrimet e prapambetura me të paktën 30%, në periudhën referuese, nga data 31.12.2025–30.6.2026.	Niveli i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në periudhën e vlerësimit kundrejt periudhës referuese është mbi 30%. Bashkitë të cilat nuk kanë detyrime të prapambetura në periudhën referuese vlerësohen me pikët maksimale për këtë tregues.
15	Bashkia ka realizim faktik të buxhetit në 6-mujorin e parë 2026 ndaj planit vjetor për vitin 2026 jo më pak se 35%.	Realizimi i buxhetit për periudhën referuese kundrejt planit vjetor të buxhetit është në nivelin mbi 35%.

16	Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me 20% në 6-mujorin e parë të 2026-ës ndaj të njëjtës periudhë të 2025-ës. Në këtë vlerësim nuk përfshihet taksa e transaksioneve mbi pasurinë e paluajtshme.	Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me 20% në 6-mujorin e parë të 2026-ës ndaj të njëjtës periudhë të 2025-ës. Në këtë vlerësim nuk përfshihet taksa e transaksioneve mbi pasurinë e paluajtshme.
----	---	---

Aneks 4

Përllogaritja e shumave që përfitojnë bashkitë

1. Fondi i GBP-së shpërndahet për çdo bashki sipas një sistemi matjeje të performancës që vlerëson përmbushjen e treguesve të vendosur.

2. Bashkive që përmbushin treguesit e GBP-së në vitin 2026 do t'u shpërndahet shuma përkatëse për secilin tregues dhe në përpjesëtim të drejtë ndërmjet bashkive fituese, si më poshtë.

3. Shpërndarja e fondit bëhet sipas dy komponentëve të GBP-së për vitin 2026.

4. Shembull. Nëse aplikojnë 61 bashki dhe pas nxjerrjes së rezultateve të vlerësimit të treguesve të performancës, 61 bashki shpallen kualifikuese nga KVA-ja, atëherë përllogaritja e shumave për t'u shpërndarë përpjesëtohet me 61 bashki.

Tregues GBP-je 2026	Pesha në %	Fondi në lekë
Komponenti I – Planet Vendore	100%	95,000,000
Plani Vendor i Mbarështimit të Pyjeve	30 %	28,500,000
Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve	20 %	19,000,000
Plani Vendor Social	15 %	14,250,000
Plani Vendor i Arsimit Parauniversitar	15 %	14,250,000
Plani Vendor i Integritetit	10 %	9,500,000
Plani Vendor i Barazisë Gjinore	10 %	9,500,000

Tregues GBP-je 2026	Pesha në %	Fondi në lekë
Komponenti II – Tregues të Matshëm Rezultati	100%	155,000,000
Shkalla e regjistrimit në kopshtet publike është jo më e vogël se 60% për vitin 2025	10%	15,500,000
% e riciklimit të të ardhurave nga ekonomia pyjore të realizuara me planifikimin/fakt në këtë sektor është jo më e vogël se 70% për vitin 2025	10%	15,500,000
Gjatë vitit 2025 bashkia ka mbuluar të paktën 50% të kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga tarifa (raporti tarifa e mbledhur/kosto e shpenzuar).	10%	15,500,000
Deri në qershor 2026, bashkitë e vogla do të shtojnë <u>1 shërbim social</u> , bashkitë e mesme <u>2 shërbime sociale</u> dhe bashkitë e mëdha <u>3 shërbime sociale</u> .	10%	15,500,000
Paketa e emergjencës për viktimat e dhunës është planifikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2026.	10%	15,500,000
Bashkia ka zbatuar gjatë vitit 2025 të paktën 50% të masave të parashikuara në Planin Vendor të Integritetit për vitin 2025.	10%	15,500,000
Bashkia ka raportuar të dhënat përkatëse për të gjithë treguesit e Raportit Kombëtar të Performancës 2025 brenda afatit të përcaktuar në udhëzim.	10%	15,500,000
Niveli i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura në periudhën e vlerësimit kundrejt periudhës referuese është mbi 30%.	10%	15,500,000
Realizimi i buxhetit për periudhën referuese kundrejt planit vjetor të buxhetit është në nivelin mbi 35%.	10%	15,500,000

Bashkia ka rritur nivelin e të ardhurave të realizuara nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme me të paktën 20% në 6-mujorin e parë të 2026-ës ndaj të njëjtës periudhë të 2025-ës.	10%	15,500,000
--	-----	------------